



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 109

Tiranë – E enjte, 16 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajonit nr. 29, datë 13.6.2016	Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I..... 5977
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajonit nr. 30, datë 13.6.2016	Për disa ndryshime në vendimet nr. 39, datë 16.10.2015, dhe nr. 1, datë 4.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve..... 5979
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajonit nr. 31, datë 13.6.2016	Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, thirrja II, për vitin 2016..... 5981
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajonit nr. 32, datë 13.6.2016	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2016, nga granti “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, e fondit për zhvillimin e rajoneve..... 5985
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajonit nr. 33, datë 13.6.2016	Për shpalljen e thirrjes II, për financimin e projekteve, nga granti 1 “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, për vitin 2016..... 5986






Tabela 1.1 Lista e disa projekteve me cikël financimi 2015-2016, Granti infrastruktura vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, vazhdimi i financimit për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vendimi i KZHR	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
QARKU DURRËS								
1	Bashkia Durrës	Rikonstruksion rruga Vrine- Fshati Rinia	Nr.39 datë 16.10.2015	120,000,000	81,333,332	38,666,668	24,000,000	57,333,332
QARKU ELBASAN								
2	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugëve "Sul Misini", "Fehmi Kotheria"	Nr.39 datë 16.10.2015	73,933,175	71,496,914	2,436,261	16,473,074	55,023,840
3	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës "25 nentoni"		90,797,561	89,667,547	1,130,014	16,473,074	73,194,473
4	Bashkia Librazhd	Ndërtim sistemim asfaltim i rrugës kryesore të fshatit Dragostunje, njësia administrative qendër	Nr.39 datë 16.10.2015	165,791,483	161,375,560	4,415,923	33,158,297	128,217,263
QARKU KORÇË								
5	Bashkia Kolonjë	Rikualifikimi i sheshit "Rilindja" dhe i fasadave	Nr.39 datë 16.10.2015	56,000,000	55,588,008	411,992	5,600,000	49,988,008
TOTALI				506,522,219	459,461,361	47,060,858	95,704,445	363,756,916

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues, mbas prokurimit, për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, dhe "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
3. "Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës", përfaqëson vlerën e përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës. Fondi i krijuar nga kjo diferencë i shtohet fondit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja, dhe ose në vazhdim të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale, për vitin 2016.
4. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
5. "Vlera e financimit për vitin 2016", tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës (mbas prokurimit) dhe vlerës së financimit për vitin 2015.

Tabela 1.2 Vazhdimi i financimit për vitin 2016, për një projekt në vazhdim, përmes grantit "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi "Zhvillimit vendor dhe rajonal", shtylla I

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit deri në vitin 2014 (në lekë)	Vlera e financimit deri në vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
1	Bashkia Roskovec	Ndërtim i Unazës së Re në Qytetin e Roskovecit	87,239,905	34,137,694	0	53,102,211
TOTALI			87,239,905	34,137,694	0	53,102,211

**Shënim:**

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim me nr.8, datë 5.10.2012, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretarati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
3. “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e alokuar deri në vitin 2014, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
4. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
5. “Vlera e financimit”, për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit deri në vitin 2014 dhe 2015.

VENDIM**Nr. 30, datë 13.6.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET
NR. 39, DATË 16.10.2015, DHE NR. 1, DATË
4.2.2016, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 18, datë 19.11.2014, nr.5, datë 9.2.2015, dhe nr. 22, datë 8.5.2015”, bëhet një ndryshim, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhë vendimit nr. 1, datë 4.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për përcaktimin e buxhetit e të drejtimeve prioritare të fondit për zhvillimin e rajoneve dhe kalendarit të programeve të

financimit, për vitin 2016”, bëhet një ndryshim, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri
Ministri i Financave
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Ministri i Zhvillimit Urban
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
Ministri i Arsimit dhe Sportit
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave
Ministri i Shëndetësisë
Ministri i Kulturës
Ministri i Mjedisit
Ministri i Punëve të Brendshme
Ministri i Shtetit për Inovacionin
dhe Administratën Publike
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar;
anëtar;

anëtar
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar



Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr.39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.15, si më poshtë vijon, në tabelën 1, të këtij vendimi i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
15	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i sheshit “Skënderbej”	1,014,543,261	202,908,652	405,817,304	405,817,304

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt, që nuk është prokuruar ende, bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban nr.3129/1 prot, datë 1.6.2016.
2. Vlera e financimit për vitin 2015, prej 202,908,652 lekësh, i shtohet portofolit të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi vendor dhe rajonal”, shtylla I, për vitin 2016. Ky fond të shpërndahet për financimin e projekteve të reja, të thirrjes së dytë, për vitin 2016, dhe/ose të projekteve në vazhdim, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.
3. Totali i vlerës së projektit si dhe vlera e financimit për vitet 2015, 2016 dhe 2017, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.39, datë 16.10.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
		TOTALI	4,365,403,906	643,094,589	2,885,810,553	836,498,765

4. Pika 15 e tabelës 1, të vendimit nr.39, datë 16.10.2015, shfuqizohet. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1, të këtij vendimi ndryshon, nga 31 projekte në 30 projekte.

Tabela 2. Në tabelën 2, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 04.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, mbas rreshtit të katërt të tabelës, shtohet rreshti, si më poshtë vijon:

Thirrja	Data	Shtylla/Programi/Granti	Projekte	Vlera e grantit për thirrje
Thirrja III	Java e fundit e qershorit	Shtylla 1 – Programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale - Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”	Drejtimet e thirrjes, masat dhe tipologjia e projekteve që do të financohen nga kjo thirrje, do të përcaktohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në mbledhjet vijuese.	Vlera e grantit për këtë thirrje do të përcaktohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në mbledhjet vijuese

**VENDIM****Nr. 31, datë 13.6.2016**

**PËRSHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË GRANTIT
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE
RAJONALE”, PROGRAMI “ZHVILLIMI I
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE”, SHTYLLA I, THIRRJA II,
PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, thirrja II, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të

drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato.

4. Ngarkohet sekretariati teknik në Ministrinë e Zhvillimit Urban, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar



Tabela 1. Lista e projekte të reja për financim nga FZHR 2016, përmes grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, Thirrja II për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
BASHKITË ME POPULLSI MBI 50,000 BANORË					
QARKU Durrës					
1	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i sheshit publik pranë Mauzoleumit, Faza I	399,811,403	199,905,702	199,905,702
2	Bashkia Durrës	Rikualifikimi i hapësirave në të dy anët e rrugës Pavarësia	171,200,752	85,600,376	85,600,376
3	Bashkia Durrës	Ndërtimi i rrugës mbi kanalin K-192, trotuar dhe ndriçim (segmenti nga ish baza e Hekurudhës deri në Stacionin Iliria Plazh)	149,999,018	74,999,509	74,999,509
QARKU TIRANË					
4	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej, Faza I	640,084,160	320,042,080	320,042,080
5	Bashkia Tiranë	Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat	332,810,688	166,405,344	166,405,344
6	Bashkia Tiranë	Itinerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe bicikletash në Parkun e Ligenit Artificial	307,584,064	153,792,032	153,792,032
7	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi i Pazarit të Ri (Markata e Mish-Peshkut, restaurim i 4 objekteve dhe rikonstruksion i fasadave ërreth sheshit Avni Rustemi dhe pajisjet)	200,281,664	100,140,832	100,140,832
QARKU ELBASAN					
8	Bashkia Elbasan	Rikualifikimi urban i sheshit "Valmi"	75,013,287	37,506,644	37,506,644
9	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës Rinia	140,692,389	70,346,195	70,346,195
10	Bashkia Elbasan	Sistemim, Asfaltimi Rruga Broshkë + Urë mbi Lumin Shkumbin	123,914,397	61,957,199	61,957,199
QARKU FIER					
11	Bashkia Fier	Ripërtëritje urbane e bulevardit "Ramis Aranitasi"	206,956,455	103,478,228	103,478,228
12	Bashkia Fier	Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale (Lagjia "Kryengritja e Fierit", Fier)	55,169,444	27,584,722	27,584,722
13	Bashkia Fier	Rikonstruksion i rrugës Daullas-Grecalli- Mujalli	152,430,421	76,215,211	76,215,211
QARKU BERAT					
14	Bashkia Berat	Rikonstruksion i rrugës "Antipatrea", segmenti Ura e Varur - Ura e Goricës (sistem trotuari, ndricim dhe riveshje me shtresa asfaltike)	55,610,958	27,805,479	27,805,479
QARKU KORÇË					
15	Bashkia Korçë	Rikualifikim urban i zonës përreth "Qytezës së femijeve", Korçë	396,195,200	198,097,600	198,097,600
16	Bashkia Korçë	Qendra polifunksionale dhe e shërbimeve	400,000,000	200,000,000	200,000,000
QARKU GJIROKASTËR					
17	Bashkia Gjirokastrë	Ndërtim i tregut industrial në qytetin e Gjirokastrës	30,271,230	15,135,615	15,135,615



BASHKITË ME POPULLSI NËN 50,000 BANORË					
QARKU SHKODËR					
1	Bashkia Pukë	Rigjenerim i shëtitores qëndrore	115,984,794	57,992,397	57,992,397
2	Bashkia Vau i Dejes	Rikualifikimi i qendrës së qytetit, Faza I	125,000,014	62,500,007	62,500,007
QARKU LEZHË					
3	Bashkia Rrëshen	Sistemim , asfaltim i rrugës Kryqëzimi autostradë, Rrëshen (Loti 1)	149,750,458	74,875,229	74,875,229
QARKU KUKËS					
4	Bashkia Tropojë	Rehabilitimi i Shëtitores së qytetit Bajram Curri	149,270,311	74,635,156	74,635,156
QARKU DIBËR					
5	Bashkia Mat	Rehabilitimi i fasadave dhe shesheve qyteti Ulëz (faza përmbyllëse)	29,983,279	14,991,640	14,991,640
QARKU DURRËS					
6	Bashkia Shijak	Rikualifikim i sheshit tek lagjia "Lugina"	25,202,594	12,601,297	12,601,297
QARKU TIRANË					
7	Bashkia Rrogozhinë	Rivitalizimi urban i qendres se qytetit te Rrogozhines	149,996,829	74,998,415	74,998,415
8	Bashkia Vorë	Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse urbane Fushë Prezë Ura e Limuthit – Bërxullë, Vorë	149,243,886	74,621,943	74,621,943
QARKU ELBASAN					
9	Bashkia Cërrik	Rikualifikim i Qendrës së Qytetit Cërrik, Loti 1	141,008,740	70,504,370	70,504,370
10	Bashkia Peqin	Sistemim asfaltim, ndërtim i korsisë së bicikletave dhe ndricim i rrugës hyrëse të qytetit, Loti 1 (segmenti Elbasan- Peqin dhe unazës së qytetit)	150,000,000	75,000,000	75,000,000
QARKU FIER					
11	Bashkia Roskovec	Projekt zhvillimor për fshatin Kuman (rikonstruksioni i rrugës në fshatin Kuman)	30,548,315	15,274,158	15,274,158
12	Bashkia Roskovec	Sistemim, asfaltim i rruges së fshatit Kurjan	148,286,386	74,143,193	74,143,193
13	Bashkia Patos	Rikonstruksioni i rrugës "Unaza"	149,160,061	74,580,030	74,580,030
14	Bashkia Patos	Rikonstruksioni i rrugës "Shën Maria" Sheqishte	55,660,876	27,830,438	27,830,438
QARKU BERAT					
15	Bashkia Poliçan	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i hyrjes se qytetit Polican/	61,008,862	30,504,431	30,504,431
QARKU KORÇË					
16	Bashkia Maliq	Rikonstruksion, sistemim asfaltim i rrugës Petrushe - Vreshtas	146,315,145	73,157,573	73,157,573
QARKU VLORË					
17	Bashkia Finiq	Rehabilitim i rrugës Dermish - Dhivër - Cerkovicë	99,500,000	49,750,000	49,750,000
18	Bashkia Selenicë	Rehabilitimi i qendrës së fshatit Brataj	17,106,176	8,553,088	8,553,088
19	Bashkia Tepelenë	Sistemimi i hyrjes së qytetit "Ali Pashë Tepelena", vazhdimi i shëtitores përgjatë kalasë, dhe i rrugës "Baba Abaz"	149,984,392	74,992,196	74,992,196
QARKU GJIROKASTËR					
20	Bashkia Dropull	Qendër multifunkionale shërbimesh (sistemi i një godine ekzistuese)	90,000,000	45,000,000	45,000,000



21	Bashkia Këlcyrë	Rikualifikim i bllokut të banesave dhe fasadave përgjatë rrugës hyrëse, Këlcyrë	70,412,165	35,206,083	35,206,083
22	Bashkia Libohovë	Rehabilitimi si edhe rikonstruksioni i rruges " Kthesa e Laboves- Labove e Kryqit	149,999,980	74,999,990	74,999,990
TOTALI			6,191,448,793	3,095,724,397	3,095,724,397

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të projektit (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përlogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016, dhe “korrektohet” nga vlera e kontratës (mbas prokurimit), pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, rialokohet dhe i shtohet portofolit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja dhe/ose projekteve në vazhdim. Vlera e plotë e projektit, sipas limitit të numrit të popullsisë të përcaktuar me vendim nr.21, datë 18.4.2016 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
2. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.
3. “Vlera e financimit për vitin 2017” tregon diferencën e financimit të vlerës së kontratës me vlerën e financimit për vitin 2016.
4. Për projektin nr.4, “Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej, Faza I”, me autoritet kontraktues Bashkinë Tiranë, është bërë anulimi i financimit me Vendim nr. 30 i KZHR, datë 13.06.2016, për projektin “Rikualifikimi urban i sheshit “Skënderbej”, miratuar më parë me Vendim nr.39, datë 16.10.2015 me vlerë 1,014,543,261 lekë, i cili nuk është prokuruar ende. Anulimi u bë me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban me Nr. 3129/1 Prot, datë 01.06.2016.
5. Për projektin nr. 22, “Rehabilitimi si edhe rikonstruksioni i rrugës " Kthesa e Labovës- Labovë e Kryqit”, me autoritet kontraktues Bashkinë Libohovë, si edhe për projektet e tjera, të financuara më sipër, ku do të ndërhyhet në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”.
6. Për projektin nr.1, “Rigjenerim i shëtitores qendrore”, me autoritet kontraktues Bashkinë Pukë, dhe vlerë 146,361,956 lekë, vlera e plotë e projektit sipas këtij vendimi është 115,984,794 Lekë. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve nuk financon zërin e preventivit “Ndërtim çatie (sip. e projektuar), në vlerën 30,618,000 Lekë, vlerë e cila është zbritur nga vlera e projektit të kërkuar. Ky zë nuk financohet dhe nuk duhet të zbatohet me financimin e dhënë në këtë vendim.
7. Për projektet e financuara më sipër, në Tabelën 1, të cilat gjejnë zbatim pranë strukturave ujore, dhe/ose lumenjve, dhe/ose përrrenjve, autoritetet kontraktuese duhet të konsultohen për zbatimin e projektit me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

**VENDIM****Nr. 32, datë 13.6.2016**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I,
PËR VITIN 2016, NGA GRANTI
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, PROGRAMI
“SHQIPËRIA DIXHITALE”, SHTYLLA III,
E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2016, për drejtimin sipas shkronjës “c”, të pikës 1.2, të vendimit nr. 12, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nga granti 1: “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik të projektit dhe të përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informim.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kofratës përkatëse për zbatimin e projektit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komi-

teti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t’i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave, dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar



Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, Thirrja I për vitin 2016, përmes Granti 1: “Shqipëria dixhitale”, Programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla e III-të e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e Projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
1	Bashkia Tiranë	Sistem i qendëruar për menaxhimin e hoteleve dhe taksave të qëndrimit në Bashkinë Tiranë.	48,000,000	33,600,000	14,400,000
		TOTALI	48,000,000	33,600,000	14,400,000

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të projektit (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përlogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016, dhe korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës (mbas prokurimit), pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit “Shqipëria dixhitale”, Programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla e III-të e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja dhe/ose projekteve në vazhdim. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike).
2. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit që alokohet nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.
3. “Vlera e financimit për vitin 2017”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës (mbas prokurimit) dhe vlerës së financimit për vitin 2016.
4. Sipas shkresës së Bashkisë Tiranë, drejtuar sekretariatit teknik, nr.17978, datë 10.6.2016, dhe shkresës së sekretariatit teknik, nr.3753, datë 9.6.2016, për këtë projekt sigurohet komunikimi i masave përkatëse, për administrimin e të dhënave dhe përdorimin e sistemit, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Autoriteti kontraktues, Bashkia Tiranë, të përfshijë në grupin e punës së projektit, përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për të siguruar krijimin e lidhjes së këtij projekti me sistemin kombëtar të turizmit.

VENDIM

Nr. 33, datë 13.6.2016

PËR SHPALLJEN E THIRRJES II, PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE, NGA GRANTI 1 “SHQIPËRIA DIXHITALE”, PROGRAMI “SHQIPËRIA DIXHITALE”, SHTYLLA III, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes II, për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti 1: “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III.

1.2 Drejtimit e thirrjes II për financim janë, për:

a) modernizimin e qyteteve dhe bashkive, përmes sistemeve të informacionit dhe shërbimeve për qytetarët, përmirësimit të eficiencës së punës dhe administrimit të bashkive të reja, rritjes së cilësisë së jetës në bashkitë e vendit.

2. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Për drejtimit sipas pikës 1.2, vlera e financimit të alokuar për këtë thirrje, prej 376 400 000 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind mijë) lekësh, të shpërndahet sipas kriterëve, si më poshtë vijon:

a) për njësitë e qeverisjes vendore, me popullsi deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për projekt. Listën e njësive të qeverisjes vendore, që janë brenda këtij niveli të



popullsisë, e dërgon në sekretariatit teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;

b) për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për projekt;

c) për Bashkinë e Tiranës, vlera e financimit do të jetë jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për projekt.

4. Procedura e vlerësimit, të projekteve të aplikuara, kryhet nga sekretariati teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas kritereve të dhëna në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar

Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në "Fletoren zyrtare"	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
27 Qershor 2016 (afat për projektet e pikës 1.2/a)	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi i projekteve sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi vetëm online në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 . 2. Për çdo informacion të nevojshëm në lidhje me aplikimin online mund të kontaktoni: - AKSHI Email: support_FZHR@akshi.gov.al (shërbimi për aplikimin online E-albania) - Sekretariati Teknik, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike Email: lorenz.bako@inovacioni.gov.al Tel: +35542277320 Pranë Sekretariatit teknik dhe Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave, <u>nuk dorëzohen dosjet fizike të aplikimit, pasi aplikimi bëhet vetëm online.</u>
3 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Sekretariati teknik pranë Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III. Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim.
3 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

**Shtojcë II: FORMATI I APLIKIMIT**

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është programi ku bën pjesë projekti (Shqipëria Dixhitale)
Nënspektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënspektori i projektit (komponentët e programit të investimit)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Përshkrimi i gjendjes aktuale - Objektivat funksionale dhe qëllimi strategjik, përputhja me politikën e sektorit dhe drejtimet e thirrjes - Zgjidhja teknologjike, impakti i pritshëm - Grupet e interesit - Logjistika dhe koha (vlerësimi i kostos, burimet, etj.) - Komunikimi me sistemet e tjera lokale ose qeveritare - Risku i realizimit të projektit.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepen grupet e interesit dhe përfitues të qartë që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Përfitimi të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi, si dhe impakti i pritshëm.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti, renditimi projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me rradhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të deklarohet, se për këtë projekt, kostoja e mirëmbajtjes së projektit, do të financohet nga aplikuesi.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (me TVSH) (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim, vlera e financimit që kërkohet nga aplikuesi është e njëjtë me koston totale të projektit. Vlera duhet të përfshijë edhe TVSH
Kontributi në rast bashkëfinancimi	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (me TVSH) (*)	Për projektet e pikës 1.2 “a” vlera e projektit ose vlera e kërkuar duhet të jetë në përputhje me kriteret, si më poshtë vijnë: - Për njësitë e qeverisjes vendore, me popullsi deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për projekt. - Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për projekt. - Për Bashkinë e Tiranës, vlera e financimit do të jetë, jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për projekt.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim (Opsionale)	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në modernizimin e qyteteve dhe bashkive. (Opsionale)	Po/Jo



Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e qyteteve dhe bashkive.	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shtetit apo të shërbimeve.
Deklarime. (*)	Aplikanti deklaron se: i. projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimi i punimeve; ii. siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iii. llogaritja e vlerës është bërë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe studimeve të tregut, në përputhje me këto akte. iv. Ka miratimet paraprake të tij (nëse aplikohen)
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - Termat e Referencës - preventivin - argumentimin teknik - përlllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit - Studimin e tregut

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

1. Dërgimi i projekt ideve sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- Aplikimi *on-line* në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi *on-line* për FZHR
<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.

2. Për çdo informacion të nevojshëm në lidhje me aplikimin online mund të kontaktoni:

- AKSHI

Email: support_FZHR@akshi.gov.al (shërbimi për aplikimin online E-albania)

- Sekretariati Teknik, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike

Email: lorence.bako@inovacioni.gov.al

Tel fix: +35542277320

**Shtojcë III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE****Pika A. Kriteret e vlerësimit teknik për projektet**

Këto kritere përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar projektin, që propozohet për financim pranë Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë**. Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike (MSHIAP), sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga aplikuesit, si dhe efektshmëria dhe dobishmëria e përdorimit të fondeve, për financimin e tij. **Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 30 pikë.**
2. Përputhja me politikën dhe drejtimit e thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.**
3. Niveli i ndikimit të projektit në modernizimin e qyteteve dhe bashkive, përmes sistemeve të informacionit dhe shërbimeve për qytetarët, përmirësimit të efikasitetit të punës dhe administrimit të bashkive të reja, rritjes së cilësisë së jetës në bashkitë e vendit, shtrirjen gjeografike të shërbimeve, impaktin që ka tek qytetarët dhe biznesi si dhe mbështetjen ndaj shërbimeve të tjera që ofrohen nga pushteti vendor, numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 20 pikë.**
4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elementë të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. **Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.**
5. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, përdorimi në kohë i outputeve të projektit, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues, etj. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë.**
6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 10 pikë.**

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi teknik, ligjor, dhe financiar i projekteve, në zbatim të ligjit për buxhetin, dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga sekretariati teknik, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratës Publike (MSHIAP), sipas kriterëve teknike të përcaktuara në këtë shtojcë.
2. Sekretariati teknik i paraqet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e plotë të projekteve që propozohen për financim, në përfundim të procesit të vlerësimit.
3. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në bashkëpunim me sekretariatit teknik, merr masat për organizimin e mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas komunikimit zyrtar të sekretariatit teknik.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë